

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

25.01.2021

Ora 12:00

**RENDI I DITËS**

Projektakti "Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16.12.2020 "Për caktimin e njërive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021".

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi KQZ Y.Merkaj, Ana Tenolli**

**Parti politike E.Salianji (PS)**

**Z.I.Celibashi:** Përshëndetje zoti Salianji!

**Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së:** Përshëndetje!


**Z.I.Celibashi:** Unë do të propozoja meqenëse përfaqësuesit e partive të tjera politike për arsye objektive, nuk mund të jenë prezent në këtë mbledhje, ta shtyjmë për pasdreke seancën publike?

**Z. E.Salianji, përfaqësues i PS-së:** Patjetër!

**Z.I.Celibashi:** Mund ta lemë në orën 17:00?

**Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së:** Lerë më mirë në 18:00!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

**Z.I.Celibashi:** Dakord, mbledhja shtyhet për në orën 18:00. Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat për njoftimin e përfaqësuesve të partitë politike që nuk ishin prezent.

**Z.Y.Merkaj:** Patjetër!

25.01.2021

Ora 18:00

**RENDI I DITËS**

*Projektakti “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 32, datë 16.12.2020 “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

<b>Ilirjan</b>	<b>CELIBASHI</b>	<b>Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b>
<b>Stafi</b>	<b>KQZ</b>	<b>Y.Merkaj, Ana Tenolli</b>
<b>Parti politike</b>		<b>I.Kaso (PD), A.Kaziaj (LSI), E.Salianji (PS)</b>

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërëma zoti Kaziaj, zoti Kaso, zoti Salianji, mirëmbërëma!

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Mirëmbërëma!

**Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së:** Mirëmbërëma!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

**Z.I.Celibashi:** Presim dhe pak minuta, ndoshta bashkohet ndonjë përfaqësues i ndonjë partie tjetër politike, presim dhe dy, tre minuta tjera dhe pastaj fillojmë. Faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Mirë, unë mendoj që të fillojmë. Atëherë, sikurse ju kemi bërë me dije, seanca publike sot është zhvilluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Sot ka në rend dite, tre çështe, tre projektvendime. Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.32, datë 16.12.2020. “Për caktimin e njësisë administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 prill 2021”, “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor” dhe projektvendimi i tretë, ka të bëjë me “Ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”. Atëherë pa humbur kohë, ia jap fjalën Sekretarit të KQZ-së, për të relatuar projektvendimin e parë. “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.32, datë 16.12.2020. “Për caktimin e njësisë administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 prill 2021”. Po, zoti Sekretar, fjala është për ju.

**Z.Y.Merkaj:** Atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.32, datë 16 dhjetor 2020, ka caktuar njësitë administrative, ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Kryetari i Bashkisë Fier, Berat, Bashkisë Dropull dhe Filiq kanë informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për mungesën e ambjenteve që ofrojnë kushte optimale, përsa u përket sipërfaqes së sigurisë dhe lidhjes në rrjet të internetit. Në njësitë administrative Levan, Mbrostar,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

Otllak, Jurgucat dhe Dërmisht. Gjithashtu ka propozuar që selitë e këtyre KZAZ-ve të krijohen në njësitë administrative si më poshtë:

Selia e KZAZ, nr.57 të krijohet në Njësinë Administrative Fier, qytet.

Selia e KZAZ nr. 58 të krijohet në Njësinë Administrative Fier qytet.

Selia e KZAZ, nr.66 të krijohet në Njësinë Administrative Berat, qytet.

Selia e KZAZ, nr.91 të krijohet në Njësinë Administrative Livadhja dhe

Selia e KZAZ, nr.82 të krijohet në Njësinë Administrative, Gramsh.

Për të gjitha këto njësi administrative të propozuara për t'u krijuar selitë e KZAZ-ve, kam referuar të dhënat në adresat përkatëse të cilat plotësojnë kriteret ligjor të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. Bazuar në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda kompetencave të tij po i paraqitet për shqyrtim projektvendimi, për miratimin për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.32, dt.16 dhjetor 2020, për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur për shqyrtim dhe miratim kemi projektvendimin e mëposhtëm:

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit zoti sekretar! Nuk e di, ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike ka ndonjë pyetje? Ose, do të diskutojë direkt lidhur me projektaktin? Me pak fjalë, ashtu sikurse dhe Sekretari e shpjegoi, ndryshimi i propozuar synon që të lihet padiskutim në një mirëadministrim të procesit zgjedhor, krijimin e një infrastrukture më të mirë për procesin e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve. Pasi ideja është për ta vendosur vendin e numërimit të votave në ato pjesë të territorit ku ka infrastrukturë nga çdo pikëpamje dhe është më e lehtë, qoftë për përfaqësuesit e partive politike, vëzhguesit, për ta mbikëqyrur këtë proces. Kemi ndonjë mendim, opinion,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

diskutim? Jo, nuk kemi. Mirë, atëherë, meqenëse dakortësohemi me përfaqësuesit e partive politike në lidhje me propozimet e prezantuara në projektaktin “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.32, datë 16.12.2020. “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 prill”. E miratoj projektaktin sipas draftit të paraqitur.

*Vendimi nr.13*

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

25.01.2021

Ora 18:11

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Stafi KQZ: Y.Merkaj, Ana Tenolli**

**Parti politike: I.Kaso (PD), A.Kaziaj (LSI), E.Salianji (PS)**

**Z.I.Celibashi:** Kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve. Fjala për ju zoti Sekretar!

**Z.Y.Merkaj:** Bazuar në vendimin e Komisionerit Nr.40, të vitit 2020 dhe Nr.5 të vitit 2021 janë caktuar partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Gjithashtu dhe partia apo kandidati kanë të drejtë të propozojnë kandidatin e shtatë të KZAZ-ve. Bazuar në këto vendime partitë politike kanë depozituar propozimet dhe dokumentacionin përkatës për anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Kështu, Partia Demokratike ka depozituar propozimet dhe dokumentacionin për 230 anëtarë dhe 46 sekretarë të KZAZ-ve. Partia Socialiste ka depozituar propozimet dhe dokumentacionin për 230 anëtarë dhe 46 sekretarë të KZAZ-ve. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka depozituar propozimet dhe dokumentacionin për 92 anëtarë të KZAZ-ve. Partia Socialdemokrate ka depozituar propozimet dhe dokumentacionin për 41 anëtarë të KZAZ-ve. Të dhënat e paraqitura nga partitë politike janë verifikuar dhe në bazë të nenit 31

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

shkronja “ç” të Kodit Zgjedhor verifikimet janë kryer dhe nga Drejtoria Përgjithshme e Burgjeve, nëse kishte vendime penale të formës së prerë ose jo. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka kryer verifikimin ka njoftuar partitë politike për mangësitë dhe ka kërkuar ridepozitimin e propozimeve përkatësisht për Partinë Demokratike në shkresën numër 414, Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim në shkresën 415, Partia Socialiste me shkresën 426 dhe Partinë Socialdemokrate me shkresën 359/1. Këto parti politike kanë depozituar dokumentacionin me mangësitë e rregulluara dhe nga ku rezulton se kandidaturat e paraqitura nga Partia Socialiste e Shqipërisë për 230 anëtarë dhe 46 sekretarë të KZAZ-ve përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni 30, 31 të Kodit Zgjedhor. Kandidaturat e paraqitura nga Partia Demokratike për 230 anëtarë dhe 46 sekretarë të KZAZ-ve përmbushin kriteret e parashikuara nga neni 30, 31 të Kodit Zgjedhor. Në shkallë vendi 80% e anëtarëve të propozuar nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike janë nga secila gjini. Gjithashtu, kandiduarat e paraqitura nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për 92 anëtarë të KZAZ-ve përmbushin kriteret e parashikuara të nenit 30, 31 të Kodit Zgjedhor. Kandidaturat e paraqitura nga Partia Socialdemokrate për 41 anëtarë të KZAZ-ve nuk plotësojnë të gjitha vendet që i përkasin kësaj partie për 92 KZAZ. 33 kandidaturat përmbushin kriteret e parashikuara nga neni 30, 31 të Kodit Zgjedhor, ndërsa 8 kandidatura nuk i përmbushin këto kriteret. Për këto kandidatura nuk janë plotësuar ende mangësitë e paraqitura nga Komisioneri. Për sa më sipër i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi i mësipërm së bashku me lidhjet bashklidhur. Lidhja 1 ku janë kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Lidhja 2 ku janë kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të Partisë Demokratike Lidhja 3 kandidaturat për anëtarë të Partisë Socialiste për Integrim dhe lidhja 4 kandidaturat

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

për anëtarë të Partisë Socialdemokrate. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shyrtim dhe miratim. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Sekretar. Ndonjë prej përfaqësuesve të partive politike dëshiron të diskutojë mbi këtë projektakt? Jo, me sa duket. Dakord, atëherë miratojmë edhe këtë projektakt sipas draftit të paraqitur.


**Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së:** Mundet, për një sugjerim?

**Z. I. Celibashi:** Po, zoti Salianji.

**Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së:** Përsa i përket projektaktit jemi njohur dhe me dokumentacionin besoj ky projektvendim është i saktë dhe duhet të kalojë me vendimmarrje, duhet të miratohet. Më pas KQZ duhet siç e parashikon dhe neni 29 për t'u shprehur për vakancat në lidhje me kandidaturat që kanë ngelur pa u plotësuar nga Partia Socialdemokrate. Besoj afati ka kaluar që kjo parti t'i paraqesë dhe nëpërmjet shkresave me KQZ-në ka pasur një koorespondencë me Partinë Socialdemokrate, ku ajo disa i ka plotësuar të tjerat nuk i ka plotësuar. Besoj që kjo vakancë do të plotësohet sipas parashikimeve të neni 29 të Kodit Zgjedhor që partia mazhorancës, domethënë mbasi shprehet vakanca kemi dhe një vendimmarrje tjetër besoj për të plotësuar vakancën, sepse projektakti është i rregullt. Thjesht për efekt kohe që të kishim marrë njoftim.

**Z.I.Celibashi:** Po. Faleminderit zoti Salianji! Ne jemi në një proces, në një procedurë komunikimi me Partinë Socialdemokrate dhe besoj që në ditët në vijim do të ketë zgjidhje dhe vendimmarrje përkatëse kjo situatë. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

*Z. E.Saliani, përfaqësues i PS-së: Dakord, faleminderit!*

*Z.I.Celibashi: Ne miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur dhe lidhjeve përkatëse mbi emrat e antarëve të KZAZ-ve dhe sektretarëve, sipas partive që kanë të drejtën për t'i bërë këto propozime si për anëtarë po ashtu dhe sektetarë të KZAZ-së.*

*Vendimi nr.14*

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

25.01.2021

Ora 18:16

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.”**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

<b>Ilijan</b>	<b>CELIBASHI</b>	<b>Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve</b>
<b>Stafi</b>	<b>KQZ</b>	<b>Y.Merkaj, Ana Tenolli</b>
<b>Parti politike</b>		<b>I.Kaso (PD), A.Kaziaj (LSI), E.Salianji (PS)</b>

**Z.I.Celibashi:** Atëherë kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës që ka të bëjë me ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të KZAZ-ve. Po, sekretar ju lutem!

**Z.Y.Merkaj:** Bazuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 8 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Administrimit të Zonave të Administrimit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr vendimin për ngritjen e KZAZ-ve jo më vonë se 90 ditë para datës së zgjedhjeve. Përcakton njësitë administrative, selitë dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e parë e KZAZ-ve si dhe njofton partitë politike të cilat kanë propozuar anëtarët e KZAZ-ve për datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZAZ-ve. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.32 datë 16 tetor 2020 ka caktuar njësitë administrative ku do të krijohen selitë e KZAZ-ve. Gjithashtu dhe kryetarët e bashkive në zbatim të përcaktimit të paragrafit të dytë të këtij neni, këtij vendimi, kanë caktuar dhe kanë dërguar informacion në KQZ për ndërtesat publike ku do të krijohen selitë e

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

KZAZ-ve, adresat dhe ambjentet përkatëse. Ndërtesat e propozuara nga kryetarët e bashkive plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 93, paragrafi i parë të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z.I.Celibashi:** Ju faleminderit zoti sekretar! Përfaqësuesit e partive politike? Po zoti Kaso.

**Z. I.Kaso, përfaqësues i PD-së:** Kisha vetëm një pyetje lidhur me aktin, se akti duket i rregullt në përgjithësi. Përse konstituohen në ditë të ndryshme, përse disa në datën 27 disa në datën 28 e kështu me rradhë?

**Z.I.Celibashi:** Është thjesht dhe vetëm për faktin që do të duhet që ky proces të mbikqyret dhe asistohet dhe nga administrata e KQZ-së dhe duke qenë se edhe situata e kovidit ka impaktin e vet, kemi bërë këtë zgjidhje. Është thjesht tërësisht teknike, pa ndonjë qëllim tjetër.

**Z.I.Kaso:** Dakord!

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit!

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Nëse mundem zoti Celibashi?

**Z.I.Celibashi:** Po, po.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Dt.25.01.2021*

*Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:* Sapo miratuam një akt që ndryshon vendimin nr.32 datë 16.12.2020 tuajin dhe pjesa relatuese e aktit që po miratojmë tani, që po shkoni të miratoni është ky vendimi i papasqyruar që është ndryshuar. Kështu që për teknalitet më shumë.

*Z.I.Celibashi:* Po keni shumë të drejtë, duhet ta reflektojmë këtë në përputhje me aktin e miratuar. Mirë dakord, nëse nuk kemi diskutime të tjera atëhere miratoj edhe projektaktin sipas draftit të propozuar! Kemi ndonjë diskutim tjetër jashtë rendit të ditës? S'kemi! Ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe ju uroj një mbrëmje të këndshme!

*Z. E.Salianji, përfaqësues i PS-së:* Faleminderit! Natën e mirë!

*Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:* Mirupafshim!

*Vendimi nr.15*

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

